



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**NR. 31 , DATË 26 / 03 /2021**

**PËR**

**VIJIMIN E PROCEDURËS TË PRISHJES SË DETYRUAR TË NJË OBJEKTI BANIMI,  
PRONË PRIVATE (PALLAT), TË NDODHUR NË NJESINË ADMINISTRATIVE NR.5 ,  
DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS SË THELLUARA TË IIARTUARA  
NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, Zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të një objekti banimi, pronë private (pallat) ndodhur në Njësitë Administrative nr.5, në zbatim të ekspertizës së thelluar, hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas tabelës si më poshtë vijon:

NR.	Nr. prot	OBJEKTE	Nr. KATI	ADRESA	GIS	PRISHJE/ RIFORCIM	NJESIA ADMINISTRATIVE
1	Nr prot 3522 data 24.02.2021. Nr prot inst 2288/5 data 23.03.2021	PALLATI ADC (DIANA BARDHI)	6 KAT	RRUGA DAVID SELENICA NR 18 , DURRES	1584	PRISHJE	NR. 5

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.

3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr. 5.
5. Ngarkohen Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtorja e Shërbimeve, Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës dhe Drejtorja e Kabinetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Dorina Milja**

*Me paosi dhe me mungese;*  
*Almeida Rosh,*



**U shpall sot më datë 01.04.2021**

BASHKIA DURRES  
Dt: 07.04.21 Nr 3356/21



IKA  
STARIA  
DURRES

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 246/prot.  
3

Durrës, më 07.04.2021

SEKRETARIA  
BASHKIA DURRËS

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 31 datë 26.03.2021 “Për vijimin e procedurës së prishjes së detyruar të një objekt banimi, pronë private (pallat), të ndodhur në Njësinë Administrative Nr. 5, Durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar të hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
ROLAND NASTO

